



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Adresa: Lagjja Kastriot, Rr. "Ramiz Aranitasi", Nr 15. Tel.355 (0) 34 410 636, e-mail: webmaster@bashkiafier.gov.al web:www.bashkiafier.gov.al

Proces – Verbal
Dëgjesa e parë publike për Planin e Detajuar Vendor të nën-njesisë strukturore 01_02

Data: 11.07.2017

Në datën **11.07.2017** në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Fier organizoi dëgjësën e parë publike për hartimin e Planit të Detajuar Vendor të nën-njesisë strukturore 01_02. Ky proces do të zhvillohet në sajë të punës së kryer nga ekipi i specialistëve të Drejtorisë së Projekteve të Infrastrukturës. Dëgjesa fokusohet në prezantimin e gjendjes ekzistuese të nën-njesisë së marrë në studim, si dhe mbi marrjen e sygjërimeve nga ana e pjesëmarrësve në dëgjësë.

Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të bashkisë, njësive administrative, Komisionit Këshillimor Qytetar, Prefekturës Fier, si dhe disa qendra sociale e qytetarë të zonës.

Nisma u prezantua nga specialisti i Drejtorisë së Projekteve të Infrastrukturës, z. Erigels Myrtaj, pas fjalës hyrëse të zëvendës/kryetares së Bashkisë Fier, znj. Enkelejda Peshkëpia. Materiali i përgatitur përmbante këto pika :

1. Analiza e nën-njesisë mbi vendndodhjen dhe pamjet e gjendjes ekzistuese
2. Analiza e nën-njesisë mbi situatën e pronësisë
3. Analiza urbane e nën-njesisë
4. Analiza e nën-njesisë mbi tipologjinë e ndërtesave, lartësinë dhe funksionet e tyre
5. Analiza e nën-njesisë mbi gjelbërimin
6. Analiza e nën-njesisë mbi fluksin dhe qarkullimin rrugor
7. Analiza e infrastrukturës: KUZ, rrjeti elektrik, ujësjellësi
8. Portofol i të dhënave të nën-njesisë të shkëputura nga dokumenti i Pasaportave, Fier

Dëgjesa zgjati 45 minuta dhe në përfundim të takimit pati një diskutim të shkurtër në lidhje me pritshmëritë mbi planin dhe procesin që do ndiqet. Nga ana e qytetarëve pati sygjërime mbi raportin e hapësirave të gjelbra dhe rekreative në propozimet e planit. Grupi i punës konfirmoi se, sipas planit të aktivitetëve, miratimi i dokumentit të Planit do ndodhë sipas rregullit kohor të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.